9. 06. 2022
03 | 47 | 941 | 6

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E EKONOMISE
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njesia Org. / Org. Jedin. / Org Unit: 02
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot No.: 1357
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: 6
Data / Datum / Date: 09.06.22
PRISHTINE A NO. 1

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria***
***Vlada-Government***
***Ministria e Ekonomisë***
***Ministarstvo Ekonomije/Ministry of Economy***

| | |
|---|---|
| **REFERENCË:** | PLANI I VEPRIMIT |
| **PËR/ZA/TO:** | znj.Vlora Spanca -Auditore e Përgjithshme/ Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës |
| **CC:** | znj. Artane Rizvanolli, Ministre/ Ministra e Ekonomisë |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | |
| **NGA/OD/FROM:** | Leonita Shabani, Zv. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Ekonomisë |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Plani i Veprimit |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. i zyrës:**<br>**Br. kancelarije:**<br>**Room No.:** | | **Lokacioni:**<br>**Kucni:**<br>**Extension:** | ME - PRISHTINË | **Data:**<br>**Datum:**<br>**Date:** | 08/062022 |

E nderuar znj. Spanca,

Bazuar në raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Ministrinë e Ekonomisë, ju lutem gjeni të bashkëlidhur Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Me respekt,

**Formulari numër: 3003/22**

**Viti: 2022**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

**Emri i Auditimit:**
RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË EKONOMISË PËR VITIN 2021- OPINION I KUALIFIKUAR

## Plani i Veprimit të Menaxhmentit për zbatim të rekomandimeve

**Për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Auditimit Nr. i Ref.**
**01 / 1059 /data/ 11/05/2022**

**Baza për Opinion të Kualifikuar**

A1 Vlera e pasurisë e prezantuar në PVF nuk ishte e saktë dhe e plotë pasiqë pasuria kapitale mbi 1,000€ ishte mbivlerësuar për 7,669,939€, përderisa në anën tjetër ishte nënvlerësuar për 42,234€.
B1 ME gjatë vitit 2021 kishte realizuar pagesa në vlerë 93,435€ për 18 punonjës (të angazhuar me Marrëveshje të Brukselit) të cilët nuk evidentohen për vijueshmërinë në punë dhe nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në Ministri.

| Nr | Rekomandimet | Veprimi i menaxhmentit | Data e planifikuar për përfundim | Personi përgjegjës | Zbatuar PO/JO | Në proces | Komentet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A-1 | Prezantimi jo i drejtë dhe jo i saktë i pasurive në pasqyrat financiare vjetore dhe në regjistrat e pasurisë ndikon në vendimet e përdoruesve të informacioneve dhe në keq menaxhimin e saj. | Të bëhet pastrimi i regjistrit të pasurive nga pasuritë që nuk janë në pronësi të Ministrisë së Ekonomisë por që janë financuar për subjektet publike. | Rekomandimi është implementuar në tërësi, në Prill/2022 | Zyrtari i pasurisë (DFSHP) | PO | | E gjithë lista e pasurive, që janë trajtuar në këtë rekomandim është implementuar.<br>Dëshmi:<br>Shkresa Nr.917 e datës 21.04.2022.<br>Raporti i Pasurisë:<br>1. Fabrika e ujit KRU Mitrovica në vlerë 7,656,844.31<br>2. Shpenzimet e Internetit në vlerë 9,994.6<br>3. 5 pajisje GPS me çmim 620 Euro vlera 3,100 Euro në total.<br>4. Një pajisje në vlerë 4,600 Euro e regjistruar<br>5. Pasuritë jo kapitale në vlerë prej 2,982 Euro me procesin e |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | ndarjes së Ministrisë janë; pasuri të: Ministrisë se Ambientit ne vlera 987, dëshmi fletë pranimi nr. 327/2021; Ministrisë së Ekonomisë i takojn komjuter dhe llaptop në vlerë prej 1,995 Euro - dëshmi fletë pranimi i mallit nga e-pasuria me nr. 347/2021, për shkak të problemeve me programin e-pasuria kjo pasuri ka mbet në draft dhe nuk eshte e mundur të finalizohet deri ne zgjidhjen e problemit te sistemit nga MAP.<br>6. Furnizim me pajisje SEM, |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | është bërë përmirësimi i datës së pranimit te mallit. |
| **B-2** | Ministrja duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore. | Sigurimi i lokacionit për të punësuarit sipas Marrëveshjes së Brukselit. Njoftimi i nëpunësve për obligimin për t'u paraqitur në vendin e punës, sipas lokacionit të përkohshëm që përcaktohet nga Ministria e Ekonomisë. | Dhjetor/ 2022 | DFSHP, Zyra e Personelit | | X | Në bashkëpunim me KRU Mitrovica është përcaktuar shfrytëzimi i një pjesë të objektit të tyre për vendosjen e këtyre nëpunësve dhe krijimin e kushteve për vijim të rregullt në punë. |
| **A-2** | Ministrja duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë pasi të hartoj një raport të përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë, duhet të krahasoj gjendjen e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare për të korrigjuar gabimet e mundshme, dhe se e gjithë kjo të përfundoj para përgatitjes së PFV për vitin 2022. | Përmes Vendimit për themelimin e Komisionit për inventarizimin e pasurisë, të percaktohet obligimi shtesë i Komisionit që të bëjë krahasimin e gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Ky veprim do të ndërmerret në koordinim me zyrtarin e pasurisë dhe zyrtarin e pranimit ne depo. | Dhjetor/2022 | Komisioni për inventarizim të pasurisë, Departamenti Ligjor, Zyrtari i pasurisë (DFSHP) | | X | Komisioni i themeluar për inventarizim të pasurisë së ME në bashkëpunim me zyrtarin e pasurisë dhe zyrtarin e pranimit të mallit në depo, përveç inventarizimit, do të bëjë edhe kontrollin dhe vendosjen e bar kodeve në të gjitha pajisjet që nuk e kanë këtë shënim, si dhe sigurimin e të dhënave se të gjitha pajisjet janë të regjistruara në regjistrin e pasurive, nëse ka të tilla. |
| **A-3** | Ministrja duhet të sigurojë që për të gjitha investimet e | Të rishqyrtohet e gjithë lista e pasurive që kanë statusin: | Tetor/ Dhjetor 2022 | Zyrtari i pasurisë | Pjesërisht | X | Investimet për RWSSP me CDI nuk janë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | realizuara në "Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve" në Prizren dhe për projekte tjera të ngjajshme të definohet pronësia e investimeve dhe njëherësh për pronat të cilat i takojnë institucioneve tjera të kryhen të gjitha procedurat e nevojshme lidhur me bartjen e pronësisë në mënyrë që gjendja e pasurisë të prezantohet saktë si dhe të evitohet mundësia për keqmenaxhim të tyre. | "Investime në vijim" dhe të evidentohen pasuritë të cilat nuk përkojnë me këtë status dhe mbi këtë bazë të bëhet pastrimi i listës së pasurive të Ministrisë së Ekonomisë. | | (DFSHP), SHGJK; DPTTI; AKEE. | | | larguar derisa të mos kemi të dhënat të sakta për përfituesit / NP-të.<br><br>Veprimet e menaxhementit deri në këto momente janë:<br><br>Ështe trajtuar lista e pasurive 'investime në vijim' ITP Prizren në vlerë 2,724,523 Euro dhe do të ndryshohet statusi nga Investime në vijim në pasuri të ME-së. |

**Menaxheri i aktivitetit / procesit të audituar:**

**Data: 08/06/2022**